



Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Data: 30.10.2019

Rritja e vlerës së kapitationit dhe përmirësimi i kualitetit në kujdesin shëndetësor primar

Të nderuar,

Nga 1 Tetori 2019, të gjithë mjekët amë të përgjithshëm, gjinekologët dhe stomatologët do të fitojnë rritje prej 15% në vlerën e kapitationit dhe për këtë, Fondi për sigurim shëndetësor ka siguruar mjete shtesë në vlerë prej 465 milion denarë në nivel vjetor.

Qëllimi i rritjes së kapitationit është përmirësimi i kapaciteteve materijale dhe teknike të mjekëve amë nga kujdesi shëndetësor primar, që ndikojnë në rritjen e efikasitetit. Pacientët do të fitojnë shërbime shëndetësore më kualitative dhe në këtë mënyrë do të zvogëlohet nevoja e udhëzimeve të mëtejshme gjegjësisht, do të lehtësohet puna e mjekëve dhe sistemi shëndetësor i nivelit sekundar dhe terciar ku do të inkurajohet preventiva në kujdesin shëndetësor primar.

Do të lehtësohet edhe puna administrative e mjekëve, pasi do të zbatohet kodimi i shërbimeve me anë të shifrave si dhe punojmë për avansimin e protokolit dhe udhëzimeve për realizimin e shërbimeve shëndetësore.

Në Fond planifikojmë përmirësimin e metodologjisë së pagesës së kapitationit përmes vlerësimit të kualitetit dhe sasisë së shërbimeve shëndetësore të ofruara, në pajtim me mjekësinë e bazuar në fakte.

Të nderuar,

Rritja e kapitationit në shëndetësinë primare është pjesë e reformave gjithpërfshirëse në sistemin shëndetësor. Këtë proces të reformave jemi duke e zbatuar në periudhë më të gjatë kohore duke inkuadruar të gjitha palët e interesuara edhe atë, Fondin si përfaqësues të personave të siguruar, Ministrinë e shëndetësisë si përfaqësues të Qeverisë, Odën e mjekëve si dhe përfaqësues të fellës profesionale.

Fondi gjithashtu do të rritë kompenzimet afërsisht për 15% të Institucioneve shëndetësore private të kujdesit shëndetësor specialistik – konsultativ, duke siguruar mjete shtesë në vlerë prej 62 milion denarë.

Fondi ka pru vendim që prej 1 Nëntori 2019 të rritet edhe kompenzimi i Barnatoreve që kanë marrëveshje me Fondin për dhënien e barnave me recetë edhe atë nga 16-18%, ndërsa kompenzimi për barnat e shtrenjta do të jetë 180 denarë për çdo recetë.

Kjo masë e kombinuar me heqjen e kuotave të Barnatoreve do të kontribuojë në dhënien më efikase, kualitative dhe pa-ndërprerje të barnave me recetë që i mbulon Fondi.

Qëllimi i reformave në kujderin shëndetësor primar për vitin 2010 është:



Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

- ✓ Të futet model i pagesave në kujdesin shëndetësor primar i cili do të kontribuojë në sigurimin gjithpërfshirës të kujdesit shëndetësor parësor nga ana e punonjësve mjekësor të nivelit primar si dhe të përmirësohet kualiteti i kujdesit shëndetësor primar.
- ✓ Ndryshimi i sistemit aktual të pagesave të mjekëve / ordinancave nga kujdesi shëndetësor primar me qëllim të sigurimit:
 - Avansimin e preventivës në kujdesin shëndetësor primar
 - Definimin dhe zbatimin e standardeve për të siguruar shërbime shëndetësore
 - Rritjen e vëllimit të shërbimeve shëndetësore nga niveli primar dhe zvogëlimin e udhëzimeve të adresuara në nivel më të lartë të kujdesit shëndetësor
 - Rritjen e numrit të mjekëve nga mjekësia e përgjithshme që do të jenë të specializuar në mjekësinë familjare
 - Rritjen e numrit të shërbimeve të ofruara nga ana e motrave mjekësore, në krahasim me gjendjen aktuale, duke inkurajuar punësimet e anëtarit të tretë për tu kyçur në ekipën mjekësore.